

LIGJ
Nr.7636, datë 12.11.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7458, DATË 22.1.1991 "PËR TË DREJTËN E GREVËS"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1, pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në kuptim të këtij ligji nuk quhet grevë ndërprerja e punës për kërkesat e grupeve të individëve ose të gjithë kolektivit që nuk kanë të bëjnë me të drejta që burojnë nga marrëdhëniet e kontratës kolektive të punës".

Neni 2

Në nenin 6 bëhen këto shtesa:

Pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e" dhe "ë" me këtë përmbajtje:

gërma "e"

"Për kërkesa që nuk janë të bazuara në kontratën kolektivetë punës".

gërma "ë"

"Në sistemin e reparteve ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes".

Pas paragrafit të fundit shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Greva e filluar në kundërshtim me shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh" dhe "e" të këtij neni është e paligjshme".

"Mosndërprerja e grevës së paligjshme i jep të drejtë punëdhënësit të marrë masat e parashikuara në nenin 11 të këtij dekreti".

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Kur pajtimi nuk arrihet dhe greva fillon, secila palë ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës", e cila brenda 10 ditëve shqyrton kërkesën dhe vendos.

Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Me paraqitjen e kërkesës në gjykatë greva pezullohet dhe punonjësit fillojnë detyrimisht punën. Në të kundërt vazhdimi i grevës e bën atë të paligjshme dhe sipas përkatësisë zbatohen masat e parashikuara në nenet 11 dhe 12 të këtij ligji.

Neni 4

Neni 12 mdryshohet si vijon:

"Për shkeljen e rregullave të parashikuara në nenet 1 (paragrafi i tretë), 5, 6, 7 dhe 9 (paragrafi i dytë) të këtij ligji, organizatorët e grevës ose personat e tjerë fajtorë dënohen me gjobë deri në 5000

lekë, ose me heqje lirie deri në 3 muaj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.365, datë 24.11.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.